

# DEMOKRACIA DJE DHE SOT



# TË GJITHË TË BARABARTË NË DEMOKRACI

ENDRIT (14), BLENDI (14), SEADI (14), LEDIONI (15), VERONA (14), ANISA (14)



## Ne, nxënësit e klasës IX-3 nga shkolla fillore „Pjetër Bogdani“ mësuam sot për demokracinë dhe funksionet e saja

Demokracia është fjalë e vogël, por me kuptim mjaft të madh kur është fjala për shtetin.

Është baza themelore e krijimit të një vendi të pavarur dhe të civilizuar. E themi këtë sepse demokracia është udhëheqje e popullit. Kjo do të thotë se ne udhëheqim përmes votës tonë, pas moshës 18 vjeçare.

Demokracinë e zhvillon populli. Populli merret si njësi themelore e krijimit të paqes dhe të harmonisë në një shtet. Ne si popull, kemi shumë të drejta.

Disa prej tyre janë: e drejta e shprehjes së mendimit, e drejta e arsimimit, e drejta për të lëvizur lirshëm, etj. Barazia nënkupton që të gjithë jemi të respektuar në mënyrë të barabartë pa dallim feje, gjinie dhe race.

Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja „demos“ që do të thotë popull, si dhe „kratia“ që do të thotë pushtet. Demokracia për herë të parë u paraqit në kryeqytetin e Greqisë, pra në Athinë.

Demokracia në atë kohë nuk ka qenë aq e zhvilluar, pasi që atëherë gratë nuk kanë pasur të drejtë vote.

Në mbledhje të shtetit merrnin pjesë vetëm burrat e pasur. Kurse sot, kemi demokraci më të kompletuar ku marrin pjesë të gjithë njerëzit, pavarësisht gjendjes ekonomike dhe gjinisë. Shteti është duke ecur në një rrugë të panjohur, kurse ne si popull jemi udhëheqësit e tij.

Ne si adoleshentë, mendojmë se shteti nuk mund të ecë përpara pa kontributin tonë. Ndihma kryesore që mund të japim ne është përmes dijes dhe kulturës sonë. Mesazhi ynë për të gjithë bashkëmoshatarët është: të ketë sa më pak dhunë, sa më shumë lumturi dhe dashuri për njëri-tjetrin.



Autorët e artikullit



# TË ZGJEDHURIT E LIRSHËM

DREN (14), DION (14), ALBION (14), URATA (14), ARBËRESHA (14), MAJLINDA (15)

## Ç'është të thotë të jesh i lirë dhe i pavarur për të zgjedhur atë që dëshiron?

Demokracia ndryshe është zgjedhje e lirë. Zgjedhje e lirë është kur ne mund të zgjedhim lirshëm p.sh. profesionin, gjërat e ndryshme që na pëlqejnë etj. Me zgjedhje nënkuptojmë procesin i cili me anë të votave zgjedhim përfaqësuesit tanë. Votat janë të fshehta në mënyrë që mos të bëhen manipulime. Zgjedhjet mund të jenë parlamentare dhe komunale. Dallimi në mes tyre është se në zgjedhjet parlamentare populli voton për deputetët, kurse në zgjedhjet komunale qytetarët votojnë për kryetarin e komunës dhe asambleistët e komunës. Në çdo vend demokratik të botës është moshë e cak-

tuar për procese zgjedhore. Në Republikën e Kosovës moshë e caktuar është 18 vjeç, sepse në këtë moshë njerëzit janë më të pjekur dhe më të vetëdijshëm për zgjedhjen e tyre.


Përfaqësuesit e popullit ndryshe quhen deputetë. Ata i përfaqësojnë interesat e popullit, dhe i përkasin partive të ndryshme. Në fushatat e tyre parazgjedhore ata shfaqin programin e tyre, japin premtime të ndryshme si për shembull, se do të hapin vende të reja pune, kushte më të mira jetese etj. Deputetët duhet të veprojnë në interes të popullit, t'i mbajnë premtimet e tyre, të jenë të besueshëm, etj.



Zgjedhje e lirë dhe e hapur



Zgjedhje e mbyllur




Votimi në proceset zgjedhore



Zgjedhja e lirë në jetën e përditshme

# NDARJA E PUSHTETIT

VERONA (14), URIM (14), AMAR (14), ERJONA (14), ANISA (14)



## Këtu do të mësoni se si bëhet ndarja e pushtetit në Republikën e Kosovës

Kosova si Republikë demokratike ka tri pushtete të ndara: Pushteti Legjislativ, Pushteti Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor.

Ndarja e pushtetit bëhet në mënyrë që shteti të funksionoj më mirë dhe secili pushtet ta kryejë punën në mënyrë të pavarur.

Në pushtetin legjislativ bën pjesë Kuvendi i cili nxjerr dhe miraton ligjet. Në Kuvendin e Kosovës bëjnë pjesë gjithsej 120 deputetë, ku 20 prej tyre i përkasin komuniteteve jo shumicë. Këta deputetë zgjedhen përmes votave të popullit. Të drejtën për të votuar e kanë personat në moshën 18 vjeçare, sepse në këtë moshë jemi më të pjekur.

Në Pushtetin Ekzekutiv bën pjesë Qeveria, e cila ekzekuton ligjet e miratuara nga Kuvendi. Në Qeveri bëjnë pjesë: Kryeministri, ministrat dhe zëvendësministrat. Ndërsa pushteti i tretë është pushteti gjyqësor në të cilin bëjnë pjesë gjykatat. Gjykatat merren me ndarjen e drejtësisë. Në gjykata bëjnë pjesë: gjyqtarët, avokatët, prokurorët, etj. Gjykatat ndahen në: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, e cila është gjykata më e lartë e shtetit.

Të tri pushtetet duhet të kujdesen që t'i trajtojnë të gjithë në mënyrë të barabartë pa dallime feje, race, gjinie apo kombi. Pra, Kosova si Republikë Demokratike e rregullon ndarjen e pushtetit me Kushtetutën e

Kosovës, përkatësisht me anë të nenit 4 të Kushtetutës. Ne si qytetarë duhet të jemi të vetëdijshëm se për kë votojmë, sepse vota jonë ndikon në mënyrën se si funksionon dhe zhvillohet shteti. Prandaj, duhet të jemi pjesëmarrës aktiv në proceset zgjedhore të vendit tonë.



Barazia është element kyç i demokracisë



Ne nxënësit e klasës IX-3 mësojmë për ndarjen e pushtetit



# ZHVILLIMI SOCIAL DHE QYTETAR

RINOR (14), DREDHZA (14), ZGJIM (15), ALBIN (14), ADON (14), SUHEJLA (14)

**Ne jemi nxënës nga shkolla „Pjetër Bogdani“ klasa IX-3. Në artikullin tonë do të lexoni më tepër për demokracinë, qytetarinë aktive, të drejtat, përgjegjësitë dhe vullnetarizmin**

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke. Fjala „demos“ do të thotë *popull*, ndërsa „kracia“ *pushtet*. Populli të cilët i përkasin një shteti quhen qytetarë.


Me fjalën vullnetarizëm kuptojmë të gjitha ato aktivitete të cilat kryhen me vetë dëshirën e personit, i cili është paraqitur vullnetar.

Secili qytetar duhet bindur ligjeve që janë të shkruara në librin e Kushtetutës, ku ndahen me nene. Secili i ka të drejtat e barabarta pa marrë parasysh fenë, racën, gjininë, moshën apo përkatësinë etnike.

Qytetarë aktiv quajmë të gjithë ata qytetarë të cilët kontribuojnë me punën që bëjnë për shtetin e tyre. Këto kontribute ndikojnë shumë mirë në zhvillimin e shtetit.

Disa nga të drejtat që u jepen qytetarëve janë: e drejta për arsimim dhe edukim, e drejta e të shprehurit lirishtëm, e drejta e votës, e drejta për shprehjen e mendimit personal, e drejta për jetesë, etj.

Njerëzit të cilët jetojnë në një shtet kanë përgjegjësi të shumta. Njëra ndër to është edhe mos shkatërrimi apo mbrojtja e ambientit në të cilin jetojnë. Ne, ambientin tonë mund ta shkatërrojmë me mbeturina të shumta, të cilat ia japin një pamje tmerruese vendit ku jetojmë. Nëse ne i hudhim mbeturinat në vendin e duhur, ne do të shikojmë se vendi ku jetojmë do të duket bukur. Secili duhet t'i respektoj të drejtat dhe përgjegjësitë personale ndaj tjetrit, duke mos iu nënshtuar ndikimeve të jashtme.



Në këtë vizatim është paraqitur ambienti i pastër



Grupi që shkroi artikullin



Kjo ishte njëra nga temat që diskutuam sot



Gjatë punëtorisë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Pjetër Bogdani“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë